



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400199/46

Tiranë ____/____/2017

Lënda: Rekomandohet vënia e sekuestros mbi pasuritë e paluajtëshme të debitorit K. e S. të Sh. për të ekzekutuar detyrimin në të holla ndaj shtetasit L. M.

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarrimit
Z. Albert PILO

Kryetarit të Zyrës Përmbarrimore Tiranë
Z. Saimir XHUGLINI

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e shtetasit L. M., i cili pretendon se prej disa vitesh nuk është ekzekutuar Vendimi Gjyqësor i formës së prerë nr. 4826, datë 18.10.2004, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me objekt:

“Detyrimin e të paditurit K. e S. të Sh. të shlyej detyrimet financiare mujore të papaguara në favor të paditësit L. M. për punën e kryer si punonjës i emëruar dhe përfaqësues i saj në Athinë, Greqi, për periudhën Janar 1998-Janar 2001, Shkurt-Mars 2004”.

Sipas përgjigjes që kemi marrë nga Zyra Përmbarrimore Tiranë, e vetmja pasuri që zotëron debitori është një automjet. Pas bllokimit fizik të automjetit dhe shitjes së tij në ankand do të shlyhet edhe detyrimi ndaj shtetasit L. M.

Ndërsa sipas ankuesit, shërbimi përmbarrimor nuk ka kryer veprimet hetimore të nevojshme për verifikimin e pasurive të debitorit pasi, përveç automjetit debitori ka në pronësi pasuri të paluajtëshme si dhe zotëron mjete monetare, me të cilat mbulon shpenzimet e aktivitetit që ushtron në një ambient të marrë me qera të mobiluar me orendi të ndryshme dhe të pajisur me kompjutera.

Për të verifikuar pretendimin e ankuesit, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar informacion nga Zyra e Përgjithshme e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme nëse subjekti Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë ka ose jo të regjistruar në emër të saj pasuri të paluajtëshme. Nga përgjigjet e marra deri tani nga ZRPP të qyteteve të ndryshme rezulton se, subjekti në fjalë ka në pronësi të saj disa pasuri të paluajtëshme. Bashkëlidhur këtij rekomandimi do të gjeni përgjigjet e ZRPP-ve që na kanë dhënë informacion për pasuritë e debitorit.

Referuar legjislacion që rregullon veprimtarinë e shërbimit përmbarimor gjyqësor, përmbaruesi duhet të marrë masa për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen ngushtë me nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara (neni 26/1 i Ligjit “*Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor*”). Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbaruesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim vullnetar, fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit (neni 527 i KPrC). Përpara vendosjes së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor sigurohet nëse sendi i paluajtshëm është në pronësi të debitorit. Për këtë, përmbaruesit gjyqësor duhet t’i paraqiten dokumente pronësie ose edhe vetë ai kërkon informata nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, nga organet financiare dhe të pushtetit lokal (neni 563 i KPrC).

Informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur deri tani provon se, përmbaruesi i ngarkuar me detyrën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor në favor të shtetasit L. M., nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme për verifikimin e pasurive të debitorit. Gjithashtu, përmbaruesi gjyqësor V. Ka., që ka patur më parë në ngarkim dosjen në fjalë, ka vendosur gjobitjen e titullarit të subjektit debitorë por, nuk na është dhënë informacion nëse është shlyer ose jo kjo gjobë. Bashkëlidhur këtij rekomandimi do të gjeni fotokopje të vendimit “*për gjobitjen e personit të ngarkuar me ligj*”.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*” si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*”

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Vënien e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme të debitorit K. e S. të Sh. për të ekzekutuar detyrimin në të holla ndaj shtetasit L. M.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI